

# EDUKIMI MEDIAL

## Tipi i Programit: Plotësues

### Historiku i Programit

Programi i trajnimit “Edukimi Medial”, buron si pjesë e projektit “Të rinjtë për digjitalizim”, që ka për qëllim fuqizimin e personelit arsimor, të rinjve, dhe komunitetit të gjerë për të dalluar dhe adresuar rreziqet që burojnë nga interneti, si dhe për të kontribuar në transformimin digjital shoqëror. Projekti përkrahët nga projekti SMART Balkans (Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor) me ndihmën e Ministrisë së Jashtme të Norvegjisë.

Programi i trajnimit ka dalë si nevojë nga transformimi digjital i shoqërisë, që përveç anës pozitive dhe përfitimeve, ka sjellë edhe rreziqe, veçanërisht në fushën e medias dhe informacionit. Qasja e lehtë në informacion ka potencial të kontribuojë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, por, mungesa e edukimit të duhur mbi përdorimin e medias dhe informacionit mund të çojë në keqinformim dhe në përhapjen e lajmeve të rreme, të cilat mund të kërcënojnë sigurinë. Sipas UNESCO-s pavarësisht se 66% e popullsisë së botës e përdor internetin, ende mungon një trajnim i gjerë dhe koherent për përdorimin e medias dhe informacionit. - Organizata Ndërkombëtare e Telekomunikacionit gjithashtu raporton se një e treta e njerëzimit ende nuk e ka përdorur plotësisht potencialin e internetit për të sjellë dobi sociale dhe ekonomike.<sup>1</sup>-Kjo situatë nënvizon nevojën se duhet bërë më shumë përpjekje për të promovuar *edukimin medial* dhe për të siguruar që qytetarët të pajisen me aftësitë e nevojshme për t'u përshtatur me kohën dhe për t'u qasur në botën digjitale në mënyrë të sigurt dhe efektive. Këtë nevojë e ka vënë në pah edhe më shumë situata pandemike (COVID-19), duke u shoqëruar me një "infodemi" – pra një tepriçë informacioni, duke përfshirë informacionet e pasakta dhe të pa verifikuara.

Në nivel shtetëror, qeveri të ndryshme e kanë kuptuar gjithashtu rëndësinë e edukimit medial dhe kanë zbatuar politika dhe programe për ta mbështetur integrimin e tij në kurrikulën shkollore, por po ashtu për t'i përgatitur qytetarët e moshave të ndryshme për transformimin digjital. Për shembull, në mënyrë të ngjashme, në Finlandë, edukimi për median është një temë e detyrueshme ndërkurrikulare në kurrikulën bërthamë, duke vënë në pah rëndësinë e nxitjes së të menduarit kritik dhe përdorimit të përgjegjshëm të medias tek nxënësit. Këso nisma demonstrojnë përkushtimin në rritje ndaj edukimit medial si një komponent jetik i përgatitjes së qytetarëve për sfidat dhe mundësitë e epokës digjitale.

Në bazë të të dhënave të Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative (TIK) për vitin 2022, shihet se përdorimi i internetit nga meshkujt është më i shpeshtë, me 55.2%, ndërsa përdorimi nga femrat

---

<sup>1</sup> International Telecommunication Union. 2022. Global Connectivity Report. <https://www.itu.int/itu-d/reports/statistics/global-connectivity-report-2022/>

është 43.6%.<sup>2</sup> Grupmosha më e madhe me qasje në internet është ajo e personave 35-44 vjeç, me një përqindje prej 21.8%, ndjekur nga moshat 45-54 vjeç (19.1%), moshat 55-64 vjeç (16.5%), moshat 16-24 vjeç (15.9%), moshat 25-34 vjeç (15.4%) dhe mosha 65+ (10.1%).<sup>3</sup> Të dhënat tregojnë qartë një nivel të barabartë të qasjes në internet nga grup-mosha të ndryshme në shoqëri. Qeveria ende nuk ka ndërmarrë hapa konkretë për adresimin e kësaj çështjeje, përkundër faktit që të dhënat theksojnë nevojën për edukim medial. Për këtë arsye, ky program i trajnimit ofron qasje strukturore dhe gjithëpërfshirëse në adresimin e çështjes së Edukimit Medial. Përmes kësaj qasjeje, programi synon të ndërhyjë në nivele të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë mbështetjen e të rinjve përmes personelit arsimor, si dhe informimin e komunitetit të gjerë.

### **Qëllimet e programit:**

Programi i trajnimit “Edukimi medial” është program që u dedikohet mësimeve dhe personelit tjetër shkollor si dhe nxënësve. Programi do t’u ndihmojë pjesëmarrësve të:

- Thellojnë njohuritë e tyre lidhur me median dhe informacionin, si dhe mënyrat se si t’i shqyrtojnë ato në mënyrë kritike;
- Reflektojnë mbi mënyrën e krijimit të botëkuptimeve dhe ndikimin që ka informacionit i shërbyer në krijimin e gjykimeve;
- Krijojnë shkathtësi të vlerësimit të informacionit në mënyrë kritike, duke analizuar faktet, burimet, kontekstin, audiencën e synuar, qëllimin dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit;
- Të fitojnë shkathtësi për të vepruar si mentorë për nxënësit e tyre që janë të angazhuar në Klubet Mediale dhe në aktivitetet e shërbimit në komunitet
- Të rrisin kreativitetin e tyre në planifikimin e mësimeve të tyre, qoftë përmes kurrikulës, aktiviteteve ndërkurrikulare apo edhe aktiviteteve jashtëkurrikulare.
- Të provojnë metoda të mësimeve që i pajisin nxënësit me kompetenca të qytetarisë demokratike, duke ndërlidhur standardet e marrjes dhe dhënies së informacionit me kulturën demokratike në një shoqëri;

### **Përmbajtja:**

Temat kryesore që mbulohen përfshijnë:

- Krijimi i botëkuptimeve/gjykimeve
- Konsumimi i informacionit
- Shqyrtimi kritik i informacionit
- Ruajtja e privatësisë
- Përgatitja për praktikë
- Përvoja me shqyrtimin kritik të informacionit
- Media dhe kompetencat qytetare
- Aktivizimi përmes fushatave online

---

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). 2022. “Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit (TIK)”

<sup>3</sup> Po aty

- Klubet Mediale dhe angazhimi me komunitetin

Programi i trajnimit ka shkallë të lartë të ndërveprimit dhe i mban pjesëmarrësit të angazhuar vazhdimisht. Ai bazohet në metodologjinë e të mësuarit përmes përvijës dhe shfrytëzon teknika të të nxëniet në bashkëpunim, të nxëniet përmes projekteve dhe të nxëniet problemor.

#### **Grupi i synuar:**

Grupi i synuar i programit të trajnimit janë mësime të ndryshme kurrikulare, e në veçanti të 'shoqëria dhe mjedisi', 'jeta dhe puna', 'gjuhët dhe komunikimi', 'artet', etj. Në këtë trajnim është e rekomandueshme të përfshihet edhe shërbimi profesional i shkollave (drejtorët, pedagogët, psikologët), koordinatorët e cilësisë, etj. Po ashtu, ky trajnim ofrohet edhe për nxënësit, pasi që tema është aktuale për të gjitha moshat.

#### **Forma e organizimit të trajnimit dhe kohëzgjatja:**

Programi i trajnimit "Edukimi Medial" i ka 20 orë të trajnimit të cilat ofrohen përmes trajnimit 2-ditor (16 orë trajnimi) me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe koha e angazhimit për përmbushjen e detyrave që lidhen me rezultatet e programit të trajnimit (4 orë trajnimi). Trajnimi 2-ditor ka gjithsej 8 sesione. Secili sesion zgjatë 90 minuta. Në mes dy ditëve të trajnimit pjesëmarrësit marrin për obligim të hulumtojnë origjinën, vërtetësinë dhe sigurinë e një lajmi të paracaktuar, të cilën e prezantojnë në fillim të ditës së dytë të trajnimit (4 orë trajnimi).

#### **Vlerësimi / Certifikimi:**

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 20 orë pedagogjike (16 orë trajnimi si dhe 4 orë punë individuale).

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje aktive në trajnim dhe
- Realizimi i punës individuale në mes të dy ditëve të trajnimit;

#### **Materialet e trajnimit:**

Dokumenti kryesor për trajnimin është Moduli i trajnimit "Edukimi Medial" Udhëzuesi për trajnerë, së bashku me fletat e punës dhe prezantimin në PPT.